

THIRRJE PËR APLIKIME:

Kampi i punës: Shtigje të trashëgimisë kulturore

11 deri më 15 nëntor 2024

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) prej kohësh e ka theksuar rolin e të rinjve në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Që nga viti 2018, OSBE-ja ka organizuar kampe rinore të trashëgimisë kulturore. Kampet u kanë dhënë të rinjve nga komunitete të ndryshme mundësinë që të përfitojnë përvojë praktike të punës në fushën e trashëgimisë kulturore, nën drejtimin e ekspertëve ndërkombëtarë. Në vitin 2024, fokusi i OSBE-së në rastin e kampit të punës së të rinjve në trashëgimi kulturore do të jetë ***Shtigje të trashëgimisë kulturore***.

Në periudhën **11-15 nëntor 2024**, OSBE-ja do të organizojë një trajnim praktik pesë-ditor ***Shtigje të trashëgimisë kulturore*** për 10 studentë universitarë që i përkasin komuniteteve të ndryshme.

Nën drejtimin e një eksperti ndërkombëtar, studentët do të mësojnë rreth shtigjeve të trashëgimisë kulturore (përfshirë objekte që u përkasin komuniteteve të ndryshme) dhe si të krijojnë një shteg të suksesshëm të trashëgimisë kulturore. Këtu mund të përfshihen udhëzimet themelore, parimet dhe kriteret për përdorimin e tyre si burime për zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik, të kuptuarit dhe respektimin e origjinalitetit dhe integritetit të trashëgimisë kulturore, ruajtjen e duhur dhe rëndësinë historike.

Trajnimi do të jetë me interes për të gjithë studentët që kanë interes në promovimin dhe/ose ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore (studentët mund të vijnë nga secili fakultet përkatës, por kjo mundësi mund të jetë me interes të veçantë për studentët e arkitekturës, antropologjisë, trashëgimisë kulturore, shkencat sociale ose turizmit). Njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme.

Sfondi

Që nga viti 2018, OSBE-ja ka organizuar kampe rinore të trashëgimisë kulturore. Këto kampe u kanë dhënë të rinjve nga komunitete të ndryshme mundësinë që të përfitojnë përvojë praktike të punës në fushën e dokumentimit, mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore, nën drejtimin e ekspertëve ndërkombëtarë.

Kur do të zhvillohet kampi i punës për trashëgiminë kulturore?



Kampi i punës është planifikuar të mbahet në Pejë, nga data 11 deri më 15 nëntor 2024.

Shpenzimet e pjesëmarrësve: Misioni i OSBE-së në Kosovë do të mbulojë të gjitha shpenzimet për pjesëmarrësit (transport dhe akomodim të plotë).

Kush mund të aplikojë?

- Studentët (përfshirë ata në nivelin Master) që kanë interes në promovimin dhe/ose ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore (studentët mund të vijnë nga secili fakultet përkatës, por kjo mundësi mund të jetë me interes të veçantë për studentët e arkitekturës, antropologjisë, trashëgimisë kulturore, shkencat sociale ose turizmit).
- Njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme (jo e detyrueshme).

Si të aplikoni?

- Studentët e interesuar duhet të dorëzojnë:
 - Një CV,
 - letër të shprehjes së interesit (maksimumi 500 fjalë, Times New Roman 12),
 - vërtetim të statusit të studentit nga fakulteti, që konfirmon statusin e tyre si studentë, si dhe drejtimin e studimeve.

Aplikimet duhet të dorëzohen deri në fund të orarit të punës më **20 tetor 2024**.

Aplikimet duhet të dorëzohen me email tek arta.shala-visoka@osce.org, duke përmendur tek Lënda: CH Trails Workcamp.

Nëse keni nevojë për ndihmë me aplikimin tuaj, ju lutemi kontaktoni në numrat e mëposhtëm:

+383 38 240100 lok. 1135

+383 49 950 219

